

VENDIM
Nr. 371, datë 11.10.1991

**PËR KRITERET DHE RREGULLAT E NDËRTIMIT TË NGREHINAVE E TË
INSTALIMEVE NË TOKAT BUJQËSORE NË PRONËSI E PËRDORIM, QË I
SHËRBEJNË SHFRYTËZIMIT BUJQËSOR E BLEKTORAL**

Me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe etë Ministrisë së Ndërtimit, në mbështetje të nenit 14 të ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 "Për token", Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Quhen ngrehina të gjitha llojet e ndërtimeve tokësore, si stallat, hangarët, depot, punishtet dhe instalimet e përhershme për përpunimin e produkteve bujqësore e blektorele. Ngehina mund të jenë të përkohshme ose të përhershme.

Ngehina të përkohshme quhen të gjitha ndërtimet që bëhen për qëllime sezonale bujqësore me materiale rrethimore, si dru, kashtë, thupër, baltë etj., nga prishja e të cilave toka rikthehet për përdorim bujqësor.

2. Sheshi i ndërtimit të ngrehinave të përhershme dhe madhësia e sipërfaqes që ato zënë përcaktohet në bazë të prodhimit që del nga sipërfaqja e tokës së dhënë, dhe të shërbimit të domosdoshëm që i bëhet asaj toke për çdo pronar ose përdorues. Norma për këtë sipërfaqe caktohet jo më shumë se 3 për qind për një dynym tokë bujqësore.

Kërkesa për sheshin e ndërtimit duhet të përmbajë të dhëna të sakta për qëllimin e ndërtimit, madhësinë e sipërfaqes së ngrehinës etj. dhe miratohet nga organi përkatës i pushtetit, në juridiksionin e të cilit banon pronari ose përdoruesi i tokës bujqësore, duke marrë më parë miratimin e seksionit të urbanistikës të komitetit ekzekutiv përkatës.

3. Ndërtimi i ngrehinave të përhershme bëhet mbi bazën e projekteve të hartuara e të miratuara nga organet projektuese shtetërore ose personat juridikë e fizikë privatë të autorizuar për projektim.

4. Ndërtimi i ngrehinave të përkohshme bëhet mbi bazën e mundësive dhe nevojave të vetë pronarit ose përdoruesit të tokës bujqësore.

5. Instalime quhen të gjitha llojet e pajisjeve që i shërbejnë rritjes së prodhimit bujqësor e blektoral të tokës bujqësore, si linjat e furnizimit me ujë për ujitje, stacionet e pompimit, kullat e ujit, pusët, kabinat elektrike dhe linjat e hyrjes dhe të daljes, linjat e telekomunikacionit, kaldajat dhe sistemi i ujitjes artificiale.

Vendosja dhe ndërtim-montimi i instalimeve bëhet sipas nevojave e dëshirës të pronarit ose përdoruesit të tokës bujqësore, në bashkërendim me organin që administron burimin përkatës dhe në përputhje me rregullat e shfrytëzimit të tyre.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
YLLI BUFI